



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 214, datë 17.10.2019

PËR

**NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 211, DATË 11.10.2019,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR CAKTIM GJYQTARI, NË NJË
ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË GJYKATËN E APELIT DURRËS”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4, 147/1/A të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në kërkesën e datës 16.10.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës për caktim gjyqtari në një çështje gjyqësore të veçantë, dhe në kushtet kur gjatë procedurave të shortit, në funksion të vendimit nr. 211 datë 11.10.2019, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ishte mbajtur parasysh se gjyqtari{...}, kishte qenë i caktuar më herët për gjykimin e çështjes penale pranë Gjykatës së Apelit Durrës,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 211, datë 11.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, pika 1, nënndarja “**Gjykata e Apelit Durrës**”, **paragrafi I**, ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda{...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkues: Shoqëria{...}; persona të interesuar:{...}, Qamil Konçi; me objekt: “Pushimi i çështjes penale”. ”.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**